



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Sh.II.nr.396/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditësit Global-AF me seli në Fushë Kosovë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.K. avokate në Prishtinë kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, rivlersim i mallit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, -Departamenti Fiskal, KF.nr.385/2022 datës 18.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.02.2024, merr këtë;

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit Global-AF me seli në Fushë Kosovë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, - Departamenti Fiskal, KF.nr.385/2022 i datës 18.12.2023, VËRTETOHET

### A R S Y E T I M I

Me aktgjykimin e ankimuar të Dhomës së shkallës së parë, është Refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Global-AF me seli në Fushë Kosovë, ndërsa ka mbet në fuqi aktvendimi i Doganës së Kosovës nr.01.3.2.2/639/2018 i dates 20.09.2021.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ankesë ka ushtruar përfaqësuesja e autorizuar e paditësit, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të: shkeljes të dispozitave të procedurës LKA, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozim që të aprovohet në tërsi ankesa e paditësit, të ndryshohet aktgjykimi i goditur me ankesë, ashtu që të aprovohet në tërsi padia dhe kërkesëpadia e paditësit, të anulohet aktvendimi i të paditurit dhe të detyrohet e paditura Dogana e Kosovës që për DUD-in R-27109 dt.28.09.2018 t,ia kthej paditësit shumën prej 1,929.14€, me kamatë ligjore 8%, apo ta prish aktgjykimin e goditur dhe ta kthej çështjen në rigjykim.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, dhe pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura në procedurën administrative të ankesave me Aktvendimin nr.01.3.2.2/639/2018 datës 20.09.2021, ka Refuzuar si të pa bazuar kërkesën e subjektit në procedurë Global-AF me seli në Fushë Kosovë, për rishqyrtimin e vendimit R-27109/28.09.2018 të ZBD Prizren

Paditësi Global-AF me seli në Fushë Kosovë, i pakënaqur me aktvendimin përfundimtar ne procedurën administrative të paditues Dogana e Kosovës në Prishtinës, ushtron padi në procedurë të konfliktit administrativ në Gjykatë.

Dhoma e shkallës së parë e Gjykatës Komerciale, në këtë çështje, mbanë seancë të shqyrtimit kryesor me datë 18.12.2023 si në vështrim të nenit 44 paragrafi 1 të LKA-së, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe pas administrimit të provave dhe vërtetimit të gjendjes faktike, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e Refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ndërsa e lën në fuqi aktvendimin e organit të paditur nr.01.3.2.2/639/2018 i datës 20.09.2021.

Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera theksohet se: gjykata nuk ka mund ti merr për bazë pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga organi i paditur, e në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe dispozitat ligjore në fuqi. Edhe pse pala paditëse i ka prezantuar gjykatës provat materiale si faturën e mallit dhe transaksionin bankar ndërkombëtar, i njëjti nuk ka arritur të dëshmoj vlerën reale të paguar për mallin lëndor, ngase transaksioni bankar i datës 19.06.2018 i referohet pro faturës KS20180611 datës 05.06.2018 e jo faturës, e cila profaturë nuk është bashkangjitur si provë, prandaj nga kjo gjendje faktike gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret duhet vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrative, për arsye se as në këtë këtë kontest paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t,ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtet e transaksionit e paguar per mallrat e shitura për eksport në Kosovës siq parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109. E paditura në rastin konkret ka vepruar drejt kur ka rivlersuar mallin e importuar nga paditësi duke dhënë arsyetim të mjaftueshëm se përse vlersimi i mallit nuk mund të bëhet me metodën e parë siq parashihet me ligj.

Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelle qenësore të dispozitave të LKA-së, dhe të LPK-së, të cilat kolegji i vlerëson, sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 194 të LPK-së. Kolegji gjen se Dhomat e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar- aktvendimit të atakuar nga paditësi, si në vështrim të nenit 44 të LKA-së, me të cilin aktvendim në procedurë administrative e gjithashtu edhe në procedurë gjyqësore sipas aktgjykimit të ankimuar me ankesë, në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se paditësi nuk ka disponuar me dokumentacion adekuat valid për tu pranuar vlera e transaksionit nga neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L109.

Kolegji e pranon si të drejtë konstatimin e Dhomës së shkallës së parë se nga provat që ka paraqit pala paditëse si në procedurë administrative gjithashtu në konflikt administrativ, nuk ka qenë e mundur të vërtetohet se vlera e dokumentacionit përcjellës të mallit lëndor është vlerë e paguar e transaksionit, të deklaruar me Deklaratën Unike Doganore R-27109/28.09.2018 të ZBD Prizren.

Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmoj para të paditurës, dhe gjykatës, vlerën e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor. Neni 33 i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, parasheh: *vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë*

Pala paditëse nuk ka arrit të dëshmoj se është paguar malli lëndor, prandaj edhe Kolegji, i pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e aktgjykimit ankimor, se dokumentacioni përcjellës i mallit i paraqitur nga paditësi nuk është i harmonizuar dhe nuk është provë e pamjaftueshme, pasi që pagesa bankare e datës 19.06.2018 i referohet një profature KS20180611 datës 05.06.2018, i cili dokument nuk gjendet në shkresat e lëndës dhe i njëjti nuk është administruar si provë nga dhoma e shkallës së parë, prandaj Kolegji vlerësoi se dhoma e shkallës së parë me të drejt ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka lënë në fuqi vendimin kontestues të paditurës 01.3.2.2/639/2018, dhe e paditura Dogana e Kosovës, me që paditësi nuk ka poseduar dokumentacion adekuat përcjellës të mallit, me të drejtë në procedurë të zhdoganimit është bazuar në të dhënat e disponueshme dhe të besueshme të Doganës së Kosovës, dhe ka rivlerësuar mallin lëndor, sipas metodës së 6 të vlerësimit, në vështrim të nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109.

Pretendimet ankimore të paditësit sipas shkaqeve të cekura në ankesë, se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të drejtë, është aplikuar gabimisht e drejta materiale, Kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i refuzon si të pa bazuara në

prova dhe fakte të dëshmuara, dhe gjen se dhomat e shkallës së parë ka nxjerrë prova të mjaftueshme nga rezulton se gjendja faktike e çështjes është vërtetuar në tërësi në mënyrë të plotë dhe të drejtë. Kolegji i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit-ankuesit se ka paraqitur vlerën reale të mallit sipas faturës, kontratës dhe transaksionit bankar që përmban përshkrimin e numrit të faturës dhe swift kodin. Kolegji vlerëson se paditësi nuk ka paraqitur dokumentacion të harmonizuar bashkëgjatë Deklaratës Unike Doganore R-27109/28.09.2018 të ZBD Prizren, meqë pagesa bankare e datës 19.06.2018 i referohet një profature KS20180611 dt.05.06.2018 e cila nuk është paraqitur nga paditësi si provë para dhomës së shkallës së parë, prandaj nuk mund të vërtetohet se kjo pagesë bankare është bërë pikërisht për mallin lëndor të paraqitur me faturën përcjellëse, për tu zbatuar neni 33 i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109.

Gjithashtu Dhomat e shkallës së dytë, nga një gjendje e tillë e çështjes, nuk aprovoi pretendimin e palës paditëse, hapjen e seancës për shqyrtim, pasi që kjo gjykatë vlerësoi se gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe mjaftueshëm nga Dhomat e shkallës së parë, dhe tani me ankes nuk ka pretendime të bazuara për të vërtetuar fakte të reja apo të merren prova të reja, të cilat do të mund të kishin ndikim në ndryshimin e një gjendje tjetër faktike (neni 190.2 i LPK-së)

Mbi këtë gjendje të fakteve Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë dhe organi administrativ përfundimtar i paditur, Dogana e Kosovës, drejtë kanë vërtetuar gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim dhe drejtë kanë zbatuar dispozitat ligjore në fuqi, dhe nuk është cënuar e drejta dhe ligji në dëm të paditësit.

Nga të lartcekurat e në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenit 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.396/24 datë 22.02.2024

Kryetari i kolegjit  
Krenar Berisha